



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
QENDRA E FORMIMIT PROFESIONAL PUBLIK ELBASAN**

Nr. 285.Prot

Elbasan më 30.03.2026

Lënda: Njoftim për vend të lirë

**DREJTORISË JURIDIKE DHE BURIMEVE NJEREZORE
DREJTORISË SË MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN
AGJENCISË KOMBËTARË TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE.**

Në zbatim të ligjit nr 15/2019, "Për nxitjen e punësimit" ; të ligjit nr 15/2017 " Për arsimin dhe formimin profesional në republikën e Shqipërisë "; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr 554 datë 31.07.2019 " Për krijimin , mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombetare të punësimit dhe aftësive ", të Udhëzimit nr 759 datë 30.09.2024 Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë, menaxhimin e burimeve njerëzore, përbërjen e njësisë së zhvillimit të Institucioneve ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar të personelit", ne Urdherin nr.3181/1.prot " Per miratimin e numrit te Instruktove dhe Mesuesve me kohe te pjesshme per vitin 2026 " protokolluar në "Qendra e Formimit Profesional Publik Elbasan me nr.52.prot ,datë 22.01.2026;

Ofruesi publik i AFP-së Qendrës së Formimit Profesional Publik Elbasan , ju njofton krijimin e vendit të lirë për pozicionet :

- Instruktor/e Riparim Kompjuteri - **1 person**
- Instruktor/e Muratimi Suvatimi, Punime Pllakashtrimi, Hekurkthim , Bojatisje, Punime ndertimi, Karpentieri -**1 person**
- Instruktor/e Aftësi për punësim - **1 person**

1. Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme :

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme si vijon:

- a) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) Të jetë në kushte shëndetësorë që e lejojnë të kryej detyrën

- c) Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale
- d) Të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- e) Të demostrojë vlera të larta të etikës, sjelljes, dhe komunikimit;
- f) Të demostrojë aftësi të punës në grup dhe të motivimit.

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon:

- a) Të ketë të paktën diplomë nga një shkollë e mesme profesionale, pas të mesme ose parauniversitare në të njëjtën fushë me kualifikimin/kualifikimet profesionale për të cilin/cilat po aplikon;
- b) Të ketë të paktën 3 (tre) vjet përvojë pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet;
- c) Të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit;
- d) Aftësi të tjera nëse kërkohen.

Dokumentet e aplikimit

1. Dosja e aplikantit e cila përmban dokumentacionin e kërkuar sipas njoftimit të vendit të lire, duhet të përfshijë.

- letermotivimin për pozicionin;
- jetëshkrimin (CV-në)
- kartën e indentitetit
- diplomë
- librezë e punës
- çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trainimet apo të tjera të përmendura në CV;
- certifikatën ose dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
- vërtetim të gjendjes shëndetësore
- vërtetimin të gjendjes gjyqësore
- vërtetim nga punëdhënësi i fundit, që ndaj tij nuk ka masa disiplinore në fuqi;
- rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm;
- dokumentet duhet të jenë origjinale ose të noterizuara;

2. Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre.

Dokumentet në gjuhën e huaj duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara. Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e ofruesit publik të AFP-së brenda datës 08.04.2026.

3. Vlerësimi i kandidatëve do bëhet referuar përcaktimeve të Udhëzimit Nr. 759, datë 30.09.2024, "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë, menaxhimin e burimeve njerëzore, përbërjen e njësisë së zhvillimit institucional, ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit", i ndryshuar.

